



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

AD.GJTH.GJL.nr.21/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesave të datës 15.11.2024 dhe 18.11.2024 të parashtruara nga ankuesi A. Sh. nga Gjilani, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtares M. A. – gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, më datë 19.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e parashtruar nga ankuesi A. Sh. nga Gjilani, e datës 15.11.2024 dhe 18.11.2024, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtares M. A. – gjyqtare në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Më datë 15.11.2024, ankuesi A. Sh. i është drejtuar kryetarit të gjykatës me ankesë urgjente duke theksuar se sa i përket lëndës C.nr.1872/20 ekzistojnë shqetësime dhe dyshime të arsyeshme se gjyqtarja M. A. mund të vazhdojë shqyrtimin gjyqësor në lëndën në fjalë me qëllim të kurdisjes së saj për favorizimin e paditësit S. dhe Xh. Sh. Me qëllim të ruajtjes së integritetit të hetimeve dhe evitimit të pasojave të pariparueshme ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtares M. A. dhe supsëndimin e saj deri në përfundimin e këtyre hetimeve disiplinore. Edhe më datë 18.11.2024, ankuesi i është drejtuar kryetarit të gjykatës me të njëjtën kërkesë që të suspendohet gjyqtarja M. A. deri në një vendim përfundimtar të hetimeve disiplinore.

Pas shqyrtimit të ankesës, bazuar në nenin 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, autoriteti kompetent konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar dhe nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore.

Pretendimet e ankuesit nuk konsistojnë në shkeljet disiplinore të parapara me këtë ligj, pasi ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete lidhur me shqetësimet dhe dyshimet e tij, e në fakt as shqetësimi

apo dyshimi i tij nuk është i konkretizuar me asnjë veprim të ndërmarrë nga gjyqtarja e çështjes, pos bindjes së tij personale se mund të kurdiset një lëndë.

Kryetari i gjykatës vlerëson se kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj një gjyqtari bazohet në shkeljet disiplinore të cilat janë të rradhitura taksativisht në nenin 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e nuk kanë të bëjnë me dyshime për kurdisje të lëndës të pabazuar me asnjë veprim, vendim apo sjellje konkrete të gjyqtarit. Gjithashtu, nga pretendimet e ankuesit nuk mund të konstatohet asnjë shkak që bie ndesh me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Ankuesi në anën tjetër ka të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike ligjore për të kundërshtuar një vendim që e konsideron jo të drejtë dhe të ligjshëm, ndërsa dyshime të tilla të paargumentuara nuk mund të prodhojnë efekt në procedurë disiplinore.

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e parashtruesit A. Sh. nga Gjilani, e datës 15.11.2024 dhe 18.11.2024, është e pabazuar dhe për të njejtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Kryetari i Gjykatës,
Venhar Salihu**

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Parashtruesit të ankesës,
2. KGJK-së
3. Dosjës së lëndës.